VENDIM
Nr. 54, datë 7.7.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PTA" (POWER TRADE ALBANIA) SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa "a"; 9 dhe 13, pika 1, germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 8 dhe 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "PTA" (Power Trade Albania) sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "PTA" (Power Trade Albania) sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht. (Mungojnë vërtetimet nga Prokuroria dhe Gjykata që personi drejtues nuk është përfshirë në një proces penal dhe struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht. (Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4.10, germa "b").

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10, dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë PTA" (Power Trade Albania) sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti